



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 126/13 prot.

Gramsh, më 11.04. 2024

V E N D I M

Nr. 27, datë 28/03 / 2024

P Ë R

MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË DO TË
MERREN PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE PUBLIKE, NGA ZJARRI
PËR VITIN 2024.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 28.03.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë, në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në ligjin nr.107/2014 datë 03.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në ligjin nr.57/2020 "Për Pyjet", në ligjin nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kulloror" i ndryshuar, në V.K.M nr.684, datë 02.09.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa të Vendimit nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", në VKM nr.288, datë 27.06.2002, "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundra zjarrit dhe shpëtimin në objekteve me rëndësi ekonomike dhe shtetërore", në VKM nr.290, datë 30.04.2004, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota", me shtresat dhe ndryshimet, në VKM nr.1080, datë 22.12.2010, "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I :

1. Të miratojë Plan – Pune, "Për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave publike nga zjarri, për vitin 2024", hartuar nga sektori i

Inspektimit dhe Mbrojtjes si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, pranë bashkisë Gramsh.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky Plan – Pune, për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave publike nga zjarri për vitin 2024, hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI



Sele. Këshillit
Dr. Sh. Pujari.

BASHKIA GRAMSH
NR REGJ 126/1
Mbërriti me Date 1/1

26.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 494/ Prot.

Elbasan, më 25.4.2024

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH
Adresa: Blv 10 Korriku, Sheshi Kamber Dyrmyshi

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit tuaj Nr.27 datë 28.03.2024 "Për miratimin e planit të punës për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave publike, nga zjarri për vitin 2024", knfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU

